



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.890/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Anton Shala kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli i parashtruar nga Anton Shala kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 10:45, ka pranuar një apel nga Anton Shala kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dega në Gjakovë, me të cilin pretendon se subjekti politik PSHDK dega në Gjakovë, ka marr gjithsej 3896 vota dhe sipas njoftimeve të para ka fituar vetëm 3 anëtar për Kuvendin Komunal dhe për këtë konsideron se i është bërë e padrejtë, pasi që sipas numrit të votave të fituara dhe në raport me partitë tjera, si subjekt i vogël do të duhej ti kishin 4 anëtar në Kuvendin Komunal.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmëris së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është i palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e pretendimeve ankimore lidhur me këtë rast për faktin se, nuk është në juridiksionin e PZAP-it që të vendos përkitazi me ndarjen e ulëseve për anëtarët në Kuvend Komunal, pasi që Komisioni Qendror Zgjedhor e bënë ndarjen e ulëseve për Kuvend pas certifikimit të rezultateve përfundimtare në bazë të rregullave të KQZ-së.

Mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli i paraqitur në PZAP për caktimin e numrit të anëtarëve në Kuvendin Komunal është i palejuar.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 11 par.5 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.890/2017 me datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltenc Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.